

---

## JETA SHKENCORE

---

### KONFERENCA SHKENCORE NDËRKOMBËTARE “KONGRES KOMBËTAR - SHKOLLË KOMBËTARE”

Më 1-2 dhjetor 2009, Qendra e Studimeve Albanologjike në bashkëpunim me Universitetin “Aleksandër Xhuvani” të Elbasanit, organizuan në qytetin e Elbasanit Konferencën Shkencore Ndërkombëtare “Kongres Kombëtar - Shkollë Kombëtare”, me rastin e 100-vjetorit të organizimit të Kongresit dhe hapjes së Shkollës Normale të Elbasanit.

Konferencës i parapriu hapja e një ekspozite në hollin e “Teatrit” të Universitetit “Aleksandër Xhuvani” të Elbasanit me pamje fotografike nga veprimtaria 100-vjeçare e Shkollës Normale (1909-2009).

Në këtë konferencë morën pjesë shumë studiues nga institucionet shkencore dhe akademike, shqiptare e të huaja, ndër të cilët studiues nga Rusia, Maqedonia, Kosova etj.

Konferenca i zhvilloi punimet me seancën e përbashkët, ku fjalën përshëndetëse e mbajtën Liman Varoshi dhe Roland Gjini nga Universiteti “Aleksandër Xhuvani” Elbasan. Më tej referuan studiuesit: Mehmet Çeliku që mbajti kumtesën me temë: *Institucionet kulturore kombëtare shqiptare për gjuhën*; Beqir Meta (Qendra e Studimeve Albanologjike-Tiranë) me kumtesën: *Procesi i konsolidimit të arsimit kombëtar në vitet 1920-1930 dhe ndikimi i Normales së Elbasanit*; Tomorr Osmani (Universiteti “Luigj Gurakuqi - Shkodër”) me kumtesën: *Rrugëtimi nga Kongresi i Manastirit në Kongresin e Elbasanit (Objektiva kulturore-arsimore)*.

Konferenca i zhvilloi punimet më tej në sesione paralele.

Në seancën e parë të sesionit paralel me temë: “Roli historik i Normales dhe i normalistëve në arsimin kombëtar” referuan studiuesit: Ramiz Kelmendi (Prishtinë): *Kontributi i normalistëve në trojet etnike shqiptare gjatë Luftës së Dytë Botërore*; Xhevat Lloshi (Tiranë): *Shkolla Normale e Elbasanit dhe gjuha letrare shqipe*, Astrit Bishqemi (Elbasan): *Hajdar Blloshmi, një nga mësuesit e parë të Normales*; Monika Stafa (Tiranë): *Lef Nosi - personalitet i dijes dhe trashëgimisë*; Teuta Toska (Elbasan): *Shkolla e Vashave dhe Normalja: realitete të njëjta me kahe të ndryshme apo realitete të ndryshme me kahe të njëjta?*, Vilson Kuri, Ilir Kanini (Elbasan): *Përpyqjet e patriotëve shqiptarë për hapjen e normaleve gatimore të Elbasanit dhe Shkodrës në vitet e Luftës së Parë Botërore*, Gëzim Sala, Shyqyri Hysi (Gjirokastrë): *Ndikimi i Kongresit të Elbasanit në zhvillimin e arsimit në trevën e Gjirokastrës*; Ali Mysliu

(Elbasan): *Vështrim i përgjithshëm mbi punimet e Kongresit kombëtar të Elbasanit.*

Në seancën e dytë të këtij paneli referuan studiuesit : Muharrem Dezhgiu (Tiranë): *Edukimi kombëtar i normalistëve dhe Lufta e Dytë Botërore në Shqipëri* ; Hyqmet Shingjergji (Elbasan): *Besim Qorri - normalist i shquar* ; Sefedin Trungu (Elbasan): *Gazeta "Tomorri" e patriotit Lef Nosi për Normalen e Elbasanit* ; Marenglen Verli (Tiranë): *Themelimi i Normales në burimet austriake*; Genci Trëndafili (Elbasan): *Disa të reja për Normalen duke hartuar një historik* ; Shaban Sinani (Tiranë): *Hasan Ceka dhe fillimet e arkeologjisë shqiptare* ; Jani Sota (Fier): *Lidhjet e Shkollës Normale të Elbasanit me arsimin në Myzeqe*; Kujtim Kopani (Elbasan): *Normalistë të shquar, kontribuues në shkencat natyrore.*

Me mjaft interes ishin edhe kumtesat e mbajtura në seancën e tretë ku referuan studiuesit: Liman Varoshi (Elbasan), Teuta Toska (Elbasan): *Politikat e programimit intelektual në dekadën e parë të shek. XX*; Eriketa Kambo (Tiranë): *Vendi i Normales së Elbasanit në arsimin shqiptar të Pasluftës së Dytë Botërore*; Hysen Shabanaj (Elbasan): *Roli i Elbasanit në historinë e arsimit kombëtar*; Kozeta Bego-Sala (Gjirokastër): *Politika austro-hungareze dhe zhvillimi i arsimit dhe i kulturës shqiptare në fund të shek. XIX dhe në fillim shek. XX*; Kujtim Bevapi (Elbasan): *Normalisti Qemal Haxhihasani*; Shpëtim Haxhihyseni (Elbasan): *Mësuesit normalistë elbasanas për shkollën dhe arsimin në Gramsh*; Rudina Mita (Elbasan): *Arsimi në Elbasan deri në mbajtjen e Kongresit të Elbasanit*; Ndriçim Mehmeti (MASH): *Disa faktorë që ndikuan në hapjen e Normales së Elbasanit.*

Kurse në sesionin paralel me temë: "Personalitete të shkencës dhe arsimit në Elbasan" kumtuuan edhe studiuesit: Pëllumb Xhufi (Tiranë): *Kontributi i Aleks Budës në studimet për mesjetën shqiptare*; Agim Leka, Kosta Giakoumis (New York University): *Ndikimi i gjuhës amtare në liturgji për përgatitjen e kushteve për arsim shqip*; Lavdosh Ahmetaj (Tiranë): *Simon Shuteriqi dhe Normalja e Elbasanit*; Aleksandër Rusakov dhe Alvina Zhugra (Universiteti i San Petërburgut, Rusi): *A.V. Desnickaja dhe Aleksandër Xhuvani*; Vehbi Hoti (Shkodër): *Luigj Gurakuqi, drejtori i parë i Normales së Elbasanit – personalitet i shquar i arsimit dhe mendimit pedagogjik shqiptar*, Uran Butka (Tiranë): *Mithat Frashëri dhe roli i tij në Kongresin e Elbasanit*; Kastriot Gjika (Tiranë): *Dhimitër Shuteriqi dhe brezi letrar i viteve 1930*; Adem Jakllari (Tiranë): *Qemal Haxhihasani dhe tezat e tij shkencore referenciale në studimet shqiptare*; Sotir Temo (Tiranë): *Mendimi pedagogjik i A. Xhuvanit - disa të dhëna të reja*; Niko Kotherja (Korçë): *Idhomene Kosturi - përfaqësues i nderuar i kulturës kombëtare*; Ndriçim Kulla (Tiranë): *Kontributi i intelektualëve shqiptarë të viteve 1930 për arsimin shqip, etj.*

Konferenca i vijoi punimet edhe me sesionin tjetër paralel me temë: “Nga formimi klasik te kurrikulat bashkëkohore”.

Kurse në sesionin e fundit paralel u referua rreth temës: “Formimi, mësimdhënia dhe kërkimi universitar, çështje të së sotme dhe të së ardhmes”.

Në përfundim të çdo seance, u zhvilluan diskutime të ndryshme. Në këto diskutime, studiuesit evidentuan disa momente të rëndësishme ku spikati roli historik i shkollës shqipe dhe i figurave të shquara të arsimit kombëtar.

Në fund të Konferencës, u zhvillua një seancë e përbashkët plenare ku u dhanë përfundimet e punimeve të konferencës, përshëndetjet dhe u bënë propozime, plane e projekte për organizimin në të ardhmen të aktiviteteve të tjera shkencore.

**Jani SOTA**



